


KOMISIONERI

për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Informim Dhe Privatësi

Revista nr.3



Nr.3
Qershor 2017

Përmbajtja

Editorial.....	faqja 3
Shkolla Dimërore “Informim dhe Privatësi” 2017.....	faqja 4
Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale.....	faqja 5
Konferenca III Kombëtare e të Drejtës për Informim	faqja 6
“Dita e internetit të sigurt” - Studimi “Privatësia dhe siguria e të dhënave personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga grupmosha 15-18 vjeç”.....	faqja 8
“Kuatridi i aftësimin të mësuesve të shkollave 9-vjeçare mbi mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve”.....	faqja 9
Konferencat Rajonale për të Drejtën e Informimit.....	faqja 10
Takim me shoqërinë civile.....	faqja 11
Mbrojtja e të Dhënave Personale në formimin vazhdues të shkollës së magjistraturës.....	faqja 12
Trajnim me studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” të Durrësit.....	faqja 12
Marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit	faqja 13
Marrëveshje bashkëpunimi me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve.....	faqja 13
Bashkëpunime ndërkombëtare.....	faqja 14

Print

Apa Albpartners sh.a.

Korrik, 2017

Revista “Informim Dhe Privatësi”

Përgatitet dhe botohet nga Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Adresa: Rr. “Abdi Toptani”, Nd. 5, Kodi postar 1001, Tiranë

Redaksia: Irma Arapi, Alketa Koja, Redi Skënderaj, Erald Mullaraj

Miratimi i ligjit “Për të drejtën e informimit” në vitin 2014 së bashku me zbatimin e tij nga institucioni i pavarur i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale i ka dhënë pikët maksimale Shqipërisë për t’u radhitur pozitivisht në Indeksin Botëror të Open Data Barometer. *Indeksi ka vlerësuar faktin se Shqipëria është i vetmi vend në rajon që në zbatim të ligjit “Për të drejtën e informimit” parashikon afatin 10 ditor si kohën në të cilën institucionet shtetërore janë të detyruar t’i kthejnë përgjigje qytetarit.*

Ligji i ri “Për të drejtën e informimit” ndryshon mentalitetin e zyrtarëve, mënyrën e qeverisjes, rrit nivelin e llogaridhënies së Autoriteteve Publike si dhe shërben si një instrument në luftën kundër korrupsionit.

Transparenca, llogaridhënia dhe lufta kundër korrupsionit janë edhe kryefjala e Reformës të sapo miratuar në Drejtësi. Kjo reformë ka ngjallur interes të veçantë për qytetarët dhe për përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët kanë përdorur ligjin “Për të drejtën e informimit” për të kërkuar institucioneve të shtetit, informacion mbi procesin e reformës.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Avokati i Popullit i janë drejtuar Zyrës së Komisionerit për opinion ligjor mbi publikimin e listës së kandidatëve, dosjeve profesionale të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe rekomandimeve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit lidhur me kandidatët për institucionet e rivlerësimit.

Zyra e Komisionerit që në fillim të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për organet e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe në të gjitha rastet e paraqitura pranë tij për mendim mbi këtë proces, i ka kushtuar rëndësi të veçantë transparencës duke e vlerësuar si një qasje të domosdoshme nga secili institucion i përfshirë, me qëllim garantimin e një rezultati përfundimtar në përputhje me pritshmëritë e publikut nga kjo reformë.

Duke marrë parasysh interesin e lartë publik që paraqet procesi i reformës në drejtësi, parimin e balancës midis të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale, Zyra e Komisionerit ka shprehur opinionin për publikimin e listës së kandidatëve për anëtar të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve; dosjet profesionale të secilit anëtar të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe rekomandimet e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit lidhur me kandidatët për institucionet e rivlerësimit.

Zyra e Komisionerit ka inkurajuar vazhdimisht të gjitha institucionet e tjera të përfshira në procesin e vlerësimit të kandidaturave të paraqitura për institucionet e vlerësimit kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve, të publikojnë në faqet e tyre zyrtare në internet si pjesë e programeve të transparencës vlerësimet dhe opinionet e dhëna për kandidaturat e paraqitura, sepse informacioni është pushtet dhe në demokraci pushteti i përket qytetarëve.

BESNIK DERVISHI

Shkolla Dimërore “Informim dhe Privatësi” 2017



Ceremonia e ndarjes së certifikatave

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Rektoratin e Universitetit të Tiranës zhvilluan në datat 23-27 janar 2017 Shkollën Dimërore “Informim dhe Privatësi”.

Stafi i Zyrës së Komisionerit mbajti prezantime për kuadrin ligjor të funksionimit dhe kompetencave të Autoritetit në të dy këto fusha, risitë e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE, trajtimin

e rasteve konkrete me procedurën e kërkesës për informim, shqyrtimin e ankesave, rolin e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe programin e transparencës së Autoriteteve Publike. Njëkohësisht, ata u njohën me të drejtat e individëve si subjekt të të dhënave personale — saktësia, grumbullimi, qëllimi, përpunimi, korrigjimi, fshirja apo arkivimi si dhe me detyrimet e kontrolluesve në raport me qytetarin. Gjithashtu, u prezantuan temat e përdorimit të të dhënave personale në rrjetet sociale dhe në Internetin e Gjërave (IoT), Cloud Computing apo Big Data si dhe balanca mes mbrojtjes së privatësisë në raport me interesin publik në legjislacionin evropian. Në ceremoninë e shpërndarjes së certifikatave për pjesëmarrësit morën pjesë Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Z. Besnik Dervishi dhe zv. Rektori i Universitetit të Tiranës Z. Shezai Rrokaj.



Ceremonia e ndarjes së certifikatave

28 Janari, Dita e Mbrojtjes së të Dhënave Personale




Ceremonia e shpalljes së fituesve

Aplikacioni fitues “IDP Ankesa” mundëson realizimin e ankesës drejtpërdrejtë nga telefoni pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Më 28 Janar, në Ditën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit organizoi eventin e ndarjes së çmimeve për aplikacionin më të mirë për privatësinë. Për realizimin e këtij konkursi Zyra e Komisionerit bashkëpunoi me Institutin Harry Fultz. Në këtë projekt u angazhuan 8 nxënës të degës së Elektronikës, të cilët të ndarë në 3 grupe punuan intensivisht për realizimin e disa modeleve që prej muajit dhjetor 2016.



Ceremonia e shpalljes së fituesve



Aplikacioni “IDP Ankesa”

Pas një periudhe plotësimi dhe testimi, aplikacioni i emërtuar tashmë “IDP Ankesa” u ngarkua në Play Store (vetëm për telefonët e sistemit Android) dhe prej 20 marsit 2017 është i disponueshëm për qytetarët. Teknologjia mobile ka potencialin për t’i bërë shërbimet më fleksibël dhe qytetarët më të informuar, pasi ata mund të kenë qasje në informacion kudo në çdo kohë nga pajisja e tyre mobile. Kjo risi i mundëson kujtqdo që të parashtojë ankesë për çdo shkelje apo keqpërdorim të të dhënave personale direkt nga telefoni i tyre. Aplikimi është efikas, i sigurt dhe i lehtë për t’u përdorur.

Si një instrument i prezantuar rishtazi, ky aplikacion synon gjithashtu të rrisë vetëdijen e individëve dhe shoqërisë, në lidhje me mbrojtjen e privatësisë së tyre.

Konferenca III Kombëtare e të Drejtës për Informim, Koordinatori dhe Shoqëria Civile

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizoi në bashkëpunim me Zyrën e Prezencës në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë “Konferencën III Kombëtare për të Drejtën e Informimit, Koordinatorin dhe Shoqëria Civile”. Me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve qendrore, atyre të qeverisjes vendore, të sistemit të drejtësisë, organizatave jo fitimprurëse dhe medias nga i gjithë vendi, ky aktivitet vlerësoi procesin e zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” nga Autoritetet Publike, që prej miratimit të tij në shtator 2014.

Në këtë Konferencë u prezantuan dy dokumenta të rëndësishme për mirëfunksionimin e Autoriteteve Publike në punën për respektimin e të drejtës për akses në dokumentat zyrtare. “Udhëzuesi për Koordinatorin e të drejtës për informim”, është manuali për nëpunësit e ngarkuar me administrimin e procesit të dhënies së informacionit për qytetarët dhe është hartuar me mbështetjen e SIGMA/OECD. Dokumenti i dytë është “Instrumenti i Vetëvlerësimit të Autoritetit Publik”, që përcakton hapat e përmbushjes së detyrimeve, në raport me dispozitat e ligjit “Për të drejtën e informimit”, të çdo institucioni të administratës publike.





Punimet e Konferencës i përshëndetën të ftuarit e nderit z. Bernd Borchardt, Kryetar i Prezencës së OSBE në Shqipëri, i cili në fjalën e tij tha se “zbatimi i ligjit “Për të drejtën e informimit” është me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të vendit dhe si i tillë, ai përbën një instrument për shoqërinë civile për të nxitur transparencën”. Nga ana e saj, znj. Valentina Leskaj, Nënkyetar i Kuvendit të Shqipërisë, theksoi “mbështetjen që i është ofruar Zyrës së Komisionerit nga parlamenti dhe vlerësoi se transparenca është kyçe për një demokraci funksionale”. Ndërsa, znj. Milena Harito, Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike tha se “roli i të gjithë aktorëve të shoqërisë është i rëndësishëm, por qeveria ka një rol të veçantë për ndërtimin e instrumentave të transparencës dhe të informimit”.

Nëpërmjet një materiali video, të pranishmit u njohën me veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit. Më shumë se 680 ankesa u trajtuan vetëm gjatë vitit 2016, ndërsa janë monitoruar rregullisht Autoritetet Publike për përmbushjen e plotë të detyrimeve në hartimin e programit të transparencës, emërimin e koordinatorit dhe mbajtjen e regjistrit të kërkesave e përgjigjeve. Stafi i Zyrës së Komisionerit ka zhvilluar aktivitete trajnuese kombëtare e rajonale me përfaqësues të institucioneve të administratës publike, veprimtari në universitete, ndërgjegjëse, etj.

Në këtë konferencë, një seancë e posaçme iu kushtua diskutimit mes përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe koordinatorëve për problematikat e ndeshura gjatë zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Të pranishmit shkëmbyen mendime, ide dhe opinione për përmirësimin e procesit të dhënies së informacionit zyrtar, i cili ndikon drejtpërdrejtë në rritjen e llogaridhënies dhe transparençën e administratës publike shqiptare.

Dita e internetit të sigurt - Studimi “Privatësia dhe siguria e të dhënave personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga grupmosha 15-18 vjeç”



Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike organizon më 10 shkurt një aktivitet në kuadër të “Ditës së internetit të sigurt”. Në këtë event, u prezantua Studimi “Privatësia dhe siguria e të dhënave personale gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga grupmosha 15-18 vjeç”, i hartuar nga Autoriteti dhe Rezoluta për “Kudrin e aftësisë së mësuesve mbi mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve” të aprovuar në Kon-

ferencën e 38-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë.

Studimi është produkt i fushatës 1-vjeçare “Privatësia dhe siguria e të dhënave gjatë përdorimit të rrjeteve sociale nga të rinjtë”. Kjo fushatë u zhvillua përgjatë vitit 2016 në 36 shkolla të mesme të përgjithshme të të gjithë vendit. Ky studim i bazuar në 1063 intervista tregon pa mëdyshje, se kjo grupmoshë e përdor masivisht internetin, ku kryesori është komunikimi nëpërmjet rrjeteve të ndryshme sociale. Ka një tendencë mes të rinjve për të patur sa më shumë llogari në rrjete të ndryshme sociale, si dhe një numër sa më të madh miqsh virtualë. Kjo prirje sjell shpesh problemin e mosnjohjes personale të të gjithë këtyre personave, çka përbën një kërcënim të drejtpërdrejtë për privatësinë e tyre dhe për mundësinë e shkakut të shqetësimeve në jetën reale. Gjetjet e këtij studimi synojnë të iniciojnë një diskutim gjithëpërfshirës mes disa institucionesh si Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, etj. Adresimi i problematikave të kësaj grupmoshe të konstatuara edhe në këtë studim është i rëndësishëm për ta kthyer temën e privatësisë në pikë referimi, kur flasim për përdorimin e sigurt të internetit dhe rrjeteve sociale.



Kuadri i aftësimit të mësuesve mbi mbrojtjen e të dhënave personale të nxënësve

Rezoluta për “Kuadrin e aftësimit të mësuesve” u miratuan në Konferencën e 38-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Ky dokument ka si objektiv të sajin që në epokën digjitale, edukimi i përgjegjshëm në përdorimin e teknologjive të reja të jetë një prioritet për veprim.

Ky “Kuadër” bazohet në 9 parime kryesore për t’iu dhënë nxënësve njohuritë bazë për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale; ndër më kryesoret e tyre përmendim: cilat janë të dhënat personale dhe si përpunohen ato në epokën digjitale; respektimi i privatësisë dhe kontrolli mbi të dhënat; kuptueshmëria e legjislacionit; si dhe mbrojtja efektive online.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, në mënyrë që parimet të cilat përbëjnë “Kuadrin e aftësimit të mësuesve” të përfshihen në kurrikulën e arsimit 9-vjeçar në një të ardhme të afërt.



Me këtë synim, Zyra e Komisionerit zhvilloi në muajin mars një takim informues me përfaqësues të Drejtorive Rajonale dhe Zyrave Arsimore të vendit, për lancimin e Kuadrit të aftësimit dhe konsultimin e tij me mësues, psikolog dhe specialist të arsimit.

Konsultimi i “Kuadrit të aftësimit” nisi në muajin maj të këtij viti në qytetin e Peshkopisë ku përfaqësuesit e Zyrës së Komisionerit u takuan me mësues të edukatës shoqërore, të informatikës

dhe psikologë të shkollave 9-vjeçare të Dibrës, Matit, Klosit dhe Bulqizës. U diskutua për parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe mënyrat për trajtimin e problematikës në këtë fushë me nxënësit. Pjesëmarrësit në takim shprehën interes për këtë temën, pasi komunikimi online po njeht një zhvillim shumë të madh midis grupmoshave të reja në vitet e fundit, dhe është një domosdoshmëri trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve në lidhje me këtë temë.



Konferencat Rajonale për të Drejtën e Informimi në Durrës, Lezhë dhe Dibër



Durrës

timi, plotësimi me sa më shumë informacion dhe përditësimi i programit të transparencës nga Autoritetet Publike.

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale ka vijuar edhe në 6 mujin e parë të vitit 2017 me trajnimin e koordinatorëve të autoriteteve publike me parimet e të drejtës për informim, detyrimet e autoriteteve publike, rolin e koordinatorit dhe programet e transparencës.

Durrësi, Lezha dhe Dibra kanë qenë tre takimet e radhës të zhvilluara nga Zyra e Komisionerit. Në këto konferenca të pranishmit janë njohur në mënyrë integrale me komponentët e ligjit, me funksionimin e Autoritetit dhe me raste praktike. Prezantimi shërben edhe si një udhërrëfyes në procesin e trajtimit të kërkesave të qytetarëve. Ndërsa, u vlerësua me rëndësi hartimi,



Dibër



Lezhë

Takim me shoqërinë civile

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Njësinë e Kërkimit dhe Zhvillimit të Politikave në Kryeministri dhe Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile çelën ciklin e parë të aktiviteteve me qëllim rritjen e kapaciteteve për krijimin e një mjedisi mundësues për shoqërinë civile.

Takimi i parë i këtij lloji, i zhvilluar në “Qendrën për Hapje dhe Dialog, COD” u fokusua në trajnimin mbi “Të drejtën e Informimit dhe Konsultimin Publik dhe rolin e organizatave të shoqërisë civile në proces”. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale informoi përfaqësuesit e shoqërisë civile mbi mundësitë që ofron Ligji 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” si dhe Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin Publik” për të kërkuar informacion mbi politikat publike si dhe për t’u bërë pjesë aktive e konsultimit të një politike apo strategjie të re qeveritare.



COD/Kryeministri

Mbrojtja e të Dhënave Personale në formimin vazhdues të shkollës së magjistraturës

Në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës u zhvillua në datat 27-28 shkurt 2017 seminari i 3-të trajnues me temë “Mbrojtja e të dhënave personale, me fokus të veçantë, mbrojtjen e të dhënave sensitive që publikohen në vendimet gjyqësore”.


Komisioneri z. Besnik Dervishi trajtoi kuadrin rregullator në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kompetencat mbikëqyrëse të Zyrës së Komisionerit nëpërmjet problematikave e rasteve konkrete të konstatuara nga trajtimi i ankesave apo nga procesi i kryerjes së hetimeve administrative. Gjyqtarët u njohën me detyrimin për anonimizimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor në raport edhe me të drejtën për informim.



Shkolla e Magjistraturës

Trajnim me studentë të Universitetit “Aleksandër Moisiu” të Durrësit

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi një trajnim me studentë dhe stafin akademik të Universitetit “Aleksandër Moisiu” të Durrësit. Ky aktivitet kishte për qëllim njohjen me kuadrin rregullator, duke i kushtuar vëmendje balancimit të dy të drejtave, si kusht për Autoritetet Publike transparente e të hapura në punën e tyre dhe të përgjegjshme për respektimin e privatësisë së individit. Nëpërmjet rasteve praktike, studentët



dhe stafi akademik, u njohën me rolin dhe funksionin e koordinatorit për të drejtën e informimit në procesin e trajtimit të kërkesave, me programin e transparencës së Autoriteteve Publike. Gjithashtu, u trajtuan edhe raste nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale, me fokus të posaçëm, përdorimin e sigurt të internetit dhe rrjeteve sociale.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”

Marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit



Kjo marrëveshje është një instrument për më shumë transparencë, si një model për shoqërinë e hapur dhe demokratike ku të drejtat dhe liritë e njeriut përbëjnë themelin e saj solid. Zyra e Komisionerit është e angazhuar që të shkëmbejë njohuritë dhe praktikat

më të përparuara në mbrojtje të të dhënave personale. Ndërsa, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, si një institucion i ri, garanton se këtë proces do ta përmbushë në respekt të plotë të privatësisë së individit, pa cenuar interesin publik. Marrëveshja promovon kulturën e gjithëpërfshirjes për njohjen dhe ushtrimin e të drejtave të qytetarëve.

Marrëveshje bashkëpunimi me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve

Marrëveshja parashikon pjesëmarrjen në aktivitete të përbashkëta trajnuese apo ndërgjegjësuere për njohjen e akteve rregullatore në fuqi në fushat ku ushtrojnë funksionet institucionet respektive. Zyra e Komisionerit dhe Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve janë dakordësuar të aplikojnë për projekte e nisma me interes për të dy palët, si dhe të shkëmbejnë informacionin në funksion të iniciativave në kuadër të veprimtarive studimore.



Konferenca Evropiane e Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale



Konferenca Evropiane

Të mbledhur në Qipro, në datat 27-28 prill, nën moton “Horizonte të reja”, 63 autoritete kombëtare dhe organizata të akredituara në këtë Konferencë, diskutuan rreth transparencës, llogaridhënien, kontrollin dhe aksesin efikas gjatë lëvizjeve kufitare të të dhënave persona, etj. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale z. Besnik Dervishi si mikpritësi i edicionit të radhës të Konferencës në vitin 2018, mbajti një prezantim ku i njohu të pranishmit me modalitetet e organizimit të

saj. Zhvillimi i këtij aktiviteti, për herë të parë në vendin tonë, është një mundësi unike jo vetëm për Autoritetin dhe shoqërinë shqiptare, por në përgjithësi për rajonin e Ballkanit perëndimor, si një shëmbull konkret integrimi.

Takimi i Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Evropës Qendrore dhe Lindore

Njohja dhe zbatimi i të drejtave të qytetarëve ishte tema kryesore e takimit të 19-të të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Evropës Qendrore dhe Lindore. Zyra e Komisionerit mbajti prezantimin me temë “Privatësia dhe siguria e të dhënave të adoleshentëve në ambientin digjital”, ku njohu të pranishmit me fushatën ndërgjegjëse të zhvilluar vitin e shkuar në 36 gjimnazet e vendit. Të dhënat kryesore të studimit, paraqetsin një panoramë të përdorimit të rrjeteve sociale nga të rinjtë e grupmoshës 15-18 vjeç, flasin për rëndësinë e përfshirjes së parimeve të privatësisë në kurrikulën shkollore.



Takimi CEEDPA

Takim me operatorët call center

Zyra e Komisionerit mikpriti përfaqësues të Autoritetit Italian të Mbrojtjes së të Dhënave Personale. Vizita e kolegëve nga vendi fqinj u zhvillua në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar në Romë, më 10 shkurt 2015, nga titullarët e institucioneve të pavarura. Pjesë e agjendës ishte dhe zhvillimi i një tryezë të rrumbullakët në nivel teknik, ku ishin të pranishëm përfaqësues të ministrive, Zyra në Shqipëri e Agjencisë Italiane për Tregtinë me Jashtë; nga shoqatat e ndryshme të biznesit; si dhe prej kompanive që ushtrojnë aktivitetin në sektorin e call center për të diskutuar mbi shqetësimet për përpunimin e të dhënave personale nga ky sektor përpunuesish të të dhënave personale.



Takim me Autoritetin Italian të Mbrojtjes së të Dhënave

për përpunimin e të dhënave personale nga ky sektor përpunuesish të të dhënave personale.

Takim i Grupit të Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacion—Grupi Berlinit

Në takimin e radhës të Grupit të Berlinit u diskutuan dokumente mbi: Privatësinë në platformat e-edukimit; Problematikën e privatësisë në “Shërbimin e Regjistrimit të gjeneratës së re (RDS)” të ICANN-it; Kërkesat qeveritare për informacionin që ruhet jashtë territorit të SHBA-ve; Përditësimi e mikro-programeve për pajisjet IoT; Automjetet e lidhura me internet; Infrastruktura inteligjente/qytetet; Televizorët inteligjentë dhe privatësia; Intimidimi kibernetik, etj. Shqipëria raportoi Udhëzimin për “Përcaktimin e nivelit të sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, inspektimet në sektorin call center dhe aplikacionin “privacy app”.




Takimi i Grupit të Berlinit

për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë, në zbatim të ligjit nr.19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, inspektimet në sektorin call center dhe aplikacionin “privacy app”.



Informim Dhe Privatësi



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Adresa:

**Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5,
Kodi postar 1001, Tiranë
E-mail: info@idp.al
TEL: +35542237200
FAX: +35542233977
Nr. i Gjelbër: 08002050**